



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 73-të të mbajtur më 18.08.2022 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-5091/1 të 17.02.2022 kundër personit -----
HIDHET POSHTË.

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-5091/1 të datës 17.05.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur----- më datë 17.05.2022 është dorëzuar denoncim kundër personit-----dhe është formuar lënda me numër 12-5091/1 të datës 17.05.2022.

Në denoncim parashtruesi thekson se personi i denoncuar kishte blerë tokë në -----e cila ishte në vijën kufitare me një arë në pronësi të tij. Babai i personit të denoncuar e ka hequr gardhin e vendosur tashmë me një ekskavator, ka hyrë në pjesën e pronës në pronësi të parashtruesit të denoncimit, me qëllim që të marrë një rrugë hyrëse për në fushë në zotërim të tij.

Në lidhje me pretendimet e denoncimit janë zhvilluar procedura gjyqësore në Gjykatën e Lartë ----- dhe Gjykatën e Apelit ----- edhe me pronarin e mëparshëm, ku objekt ishte përcaktimi i të drejtës së pronësisë dhe përdorimit të sipërfaqes së diskutueshme të tokës.

Parashtruesi i denoncimit iu drejtua Agjencisë së Kadastrës së Pasurive të Paluajjtshme të RMV-së me një peticion për çdo pakënaqësi të shprehur për gjendjen e regjistruar, nga ku mori një shpjegim gjithëpërfshirës dhe udhëzime për barazimin që nëse gjendja aktuale nuk përputhet

me gjendjen e regjistruar në AKPP, të paraqesë një kërkesë përkatëse me dokumentacion të bashkëngjitur ku ndër të tjera thuhet se duhet të paraqesë një raport gjeodezik që do të përfshijë zonën e kontestuar.

Parashtruesi i denoncimit në KSHPK thekson se nuk është në gjendje të siguroj elaboratin gjeodezik për shkak se personat e aftë në subjektet për punë gjeodezike dhe kadastrale kanë qenë të korruptuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve , KSHPK-ja konstaton se në rastin bëhet fjalë për pretendime që nuk i nënshtrohen veprimit të saj kompetent, por janë pretendime që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të një organi tjetër kompetent, ku parashtruesi ka përmendur që do t'i drejtohet, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:

Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: Mr. K.Z.

Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHITETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Kryetare,
Biljana Ivanovska
